



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 940/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022 dhe 102-të mbajtur më 14.07.2022 mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohen** programet e studimeve në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” FSHMN, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
 1. *Gjeografi, BSc, 180 ECTS*, maksimumi 70 studentë për vit akademik,
 2. *Gjeografi, MSc, 120 ECTS*, maksimumi 20 studentë për vit akademik,
 3. *Fizikë, BSc, 180 ECTS*, maksimumi 80 studentë për vit akademik,
 4. *Fizikë, MSc, 120 ECTS*, maksimumi 20 studentë për vit akademik.
- II. **Riakreditohen** programet e studimeve në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” FSHMN, për periudhën tre (3) vjeçare, duke filluar nga 1 tetor 2022 deri me 30 shtator 2025:
 5. *Biologji, MSc, 120 ECTS*, maksimumi 30 studentë për vit akademik,
 6. *Shkenca kompjuterike MSc, 120 ECTS*, maksimumi 30 studentë për vit akademik,
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” FSHMN, Prishtinë që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” FSHMN, Prishtinë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programit të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.

VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” FSHMN, Prishtinë në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për ri akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Gjeografi, BSc, 180 ECTS,</i> Riakreditim	Florim Isufi Arsim Ejupi Valbon Bytyqi
2.	<i>Gjeografi, MSc, 120 ECTS,</i> Riakreditim	Mimoza Dushi Fitim Humolli
3.	<i>Fizikë, BSc, 180 ECTS</i> Riakreditim	Sefer Avdiaj Shukri Klinaku Skender Kabashi
4.	<i>Fizikë, MSc, 120 ECTS,</i> Riakreditim	Fisnik Aliaj Gazmend Nafezi
5.	<i>Biologji, MSc, 120 ECTS,</i> Riakreditim	Ferdije Zhushi-Etemi Bekim Gashi
6.	<i>Shkenca kompjuterike MSc, 120 ECTS</i> Riakreditim	Eliot Bytyçi Behar Baxhaku

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” FSHMN, në Prishtinë me këtë përbërje: Thomas Theis Nielsen, Juraj Bogat, Herbert Stoeri, Damian Michalik, Mladen Krajacic dhe Lali Giorgidze, Ahmad Zargari, Marko Komso. Vizita është organizuar me datat: 17.05.2022, 18.05.2022, 17.06.2022, 02.06.2022, 27.05.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për këtë program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Gjeografi, BSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4), substancialisht tre (3) standarde.
2. Për programin e studimit *Gjeografi, MSc, 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4), substancialisht tre (3) standarde.
3. Për programin e studimit *Fizikë, BSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht pesë (5) standarde.
4. Për programin e studimit *Për programin e studimit Fizikë, MSc, 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht pesë (5) standarde.
5. Për programin e studimit *Biologji, MSc, 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht një (1) standarde.
6. Për programin e studimit *Shkenca kompjuterike MSc, 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht katër (4) dhe pjesërisht një (1) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e FSHMN, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

